Бр./Nr________

_________г./v.

**VENDIM**

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 84-të, të mbajtur më 31.03.2023, morri vendimin vijues:

**VENDIM**

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2508/1 të datës 22.07.2020, me pohime për kritere të kufizuara në procedurën për furnizime publike të pajisjeve në /// të///, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja përcaktoi se në përputhje me ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent të mëtutjeshëm për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-2508/1 të datës 22.07.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

**Arsyetim**

Nga një parashtrues, person juridik me seli në ///, ///, ka paraqitur një raport në disa institucione, përfshirë edhe KSHPK-në, me pretendimet për kritere kufizuese të procedurës për furnizime publike të pajisjeve në /// filialin e //, dhe është formuar lënda me numër 12-2508/1, datë 22.07.2020.

Në denoncim, parashtruesi, pa specifikuar persona dhe veprime konkrete, thekson se një nga kushtet që përmban dokumentacioni i tenderit nga procedura e prokurimit publik të pajisjeve për /// nga /// e SHA /// e kufizon konkurrenca, sepse kushti nënkuptonte që pjesët e këmbimit të prodhoheshin nga prodhuesi i turbinave të përdorura nga Ndërmarrja e Re /// (///), ose nga një kompani e autorizuar prej saj (///). Parashtruesi beson se rrethanat e përshkruara më sipër tregojnë rrezik korrupsioni dhe beson se ato janë në drejtim të favorizimit të një operatori, gjë që

do ta bënte çmimin e blerjes më të lartë. Në fund të denoncimit, parashtruesi kërkon të bëjë ndryshime në kushtet për prokurimin publik të specifikuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK ka konstatuar se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme dhe i është dorëzuar institucioneve tjera kompetente, përkatësisht drejtorit të AD ///, komisionit të prokurimit publik të ///, si dhe Prokurorisë Publike të RMV-së. Për sa më sipër, si dhe faktin se për pretendimet janë njoftuar edhe institucionet tjera kompetente, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përpiloi: A.R.M.
Miratoi: Mr. V.G., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR**
**PËR PARANDLAIMIN E KORRUPSIONIT**
**Nënkryetar,**
**Katica Nikolovska**

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk